



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:142704
Datë: 19.09.2022
Numri i dokumentit: 03432300

CP.nr.158/2022

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, gjyqtari **Betim Behluli**, në çështjen juridike të përmbarimit sipas propozimit për përmbarim të kreditorit të përmbarimit M. B. nga Prizreni, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i tyre i autorizuar Av. D. M. nga Prizreni, i paraqitur kundër debitores së përmbarimit Komunës së Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) në Rahovec, e për përmbarimin e dokumentit të përmbarimit – aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, Dega Rahovec, C.nr.476/2019, të datës 21.04.2021, i plotfuqishëm dhe ekzekutueshëm, për shkak të detyrimit në të holla në emër të pagave jubilarë në shumë të përgjithshme prej **3,115.20** Euro, duke vendosur për debitimin e mjeteve përmes xhirollogarive gjegjëse bankare, jashtë seancës gjyqësore, me dt. 19.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. URDHËROHET, Ministria e Financave e Republikës së Kosovës në Prishtinë – Llogaria e vetme e Thesarit, që në emër të detyrimit të përcaktuar me aktvendimin e kësaj gjykate, CP.nr.158/2022 të datës 12.07.2022, për lejimin e përmbarimit të dokumentit të përmbarimit - aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, Dega Rahovec, C.nr.476/2019, të datës 21.04.2021, i plotfuqishëm dhe ekzekutueshëm, për shkak të detyrimit, kreditorit **M. B.**, shumë prej **3,115.20 €**, me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga dita e marrjes së aktgjykimit prej datës 19.12.2019 deri me datën 08.08.2022, sipas ekspertizës të ekspertit financiar, shumë prej 318.06 €, apo shumë të përgjithshme prej **3,433.62**, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore **gjithsejtë në shumë prej 227,00** Euro dhe atë për propozim shumë prej 156,00 Euro, për taksë gjyqësore shumë prej 31,00 Euro si dhe 40,00 Euro për ekspertizë financiare, në atë mënyrë që nga xhirollogaria bankare e debitores së përmbarimit, Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec, me **nr.1000650250000012**, e cila gjendet te BQK-ja me seli në Prishtinë, t'i bart këto mjetet monetare, në llogari të veçantë bankare të përfaqësuesit të autorizuar të kreditorëve av. D. M. në xhirollogarinë e tij bankare, me **nr. 1404-0000-0379-8743** pranë Bankës Ekonomike.

II. OBLIGOHET, Ministria e Financave e Republikës së Kosovës – Llogaria e vetme e Thesarit në Prishtinë, që gjykatën t'a njoftoj me shkrim për zbatimin e këtij aktvendimi ose për arsyet e mos zbatimit të tij.

A r s y e t i m

Gjykata propozimin për ekzekutim ia ka dërguar të paditurës Komunës së Rahovec, për përgjigje mirëpo e njëjta edhe pse e ka pranuar propozimin me datë 12.07.2022, e njëjta nuk ka ushtruar përpjesim.

Meqenëse pala kreditore në propozimin e saj për përmbarim, ka cekur mjetin gjegjës të përmbarimit - transferimin e mjeteve monetare përmes xhirollogarive bankare e me qëllim të realizimit të detyrimit të lartë cekur në të holla dhe se pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, kjo gjykatë gjeti se në rastin konkret, duhet të bëhet debitimi i mjeteve të lartcekura monetare në emër të të pagave jubilarë, t'ia paguaj kreditorit M. B., shumën prej 3,115.20 €, me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga dita e marrjes së aktgjykimit prej datës 19.12.2019 deri me datën 08.08.2022, sipas ekspertizës të ekspertit financiar, shumën prej 318.06 €, apo shumën e përgjithshme prej 3,433.62, si dhe në po të njëjtin afat ti paguaj edhe shpenzimet procedurale dhe atë në shumën e lartë cekur përmes bartjes së tyre përmes xhirollogarive gjegjëse bankare dhe atë për këtë arsye:

Me shikim në shkresat e lëndës, CP.nr.158/2022 të datës 12.07.2022, kjo gjykatë ka gjetur se në rastin konkret pjesë e detyrimit që rrjedh nga dokumenti i përmbarimit – aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, Dega Rahovec, C.nr.476/2019, të datës 21.04.2021, i plotfuqishëm dhe ekzekutueshëm e për shkak të detyrimit në të holla, është kompensimi gjegjës në të holla i përshkruar si më lartë e përkitazi me përmbarimin për realizimin e kredisë në të holla kundër debitorës së përmbarimit, si në rastin konkret me debitimin e mjeteve financiare përmes xhirollogarive gjegjëse bankare, bëhet fjalë në nenin 152 të LPP-së e në rastin konkret, duke u bazuar në dokumentin e lartë cekur përmbarimit, se debitorja e përmbarimit, Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komonale e Arsimit në Rahovec, është e obliguar që kreditorit të përmbarimit, M. B., shumën prej 3,115.20 €, me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga dita e marrjes së aktgjykimit prej datës 19.12.2019 deri me datën 08.08.2022, sipas ekspertizës të ekspertit financiar, shumën prej 318.06 €, apo shumën e përgjithshme prej 3,433.62, €, të llogaritur në bazë të ekspertizës së ekspertit M. D. prej datës 08.08.2022, si dhe shpenzimet procedurale dhe atë në shumën e lartë cekur, andaj me arsyet e cekura më lartë kjo gjykatë, vendosi që të urdhëroj Ministrinë e Financave me seli në Prishtinë - Llogarinë e Thesarit, që të bëjë debitimin e mjeteve monetare në shumën e lartcekur e më gjerësisht me përshkrimin e bërë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në kuptim të nenit 3, 5 par.6 pika 2, 109 par.3, 113 dhe nenin 152 të LPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
CP.nr.158/2022, më 19.09.2022

Gj y q t a r i
Betim Behluli

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë e veçantë.